



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM (ME NJE OPERATOR)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit të cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, në cilësinë e porositësit të shërbimeve të Autoritetit Kontraktues në njërën anë;

dhe

“**SHKËMBI**” SHPK të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, në cilësinë e menaxherit Zona Industriale në Istog, me Nr. Rexhistrimit të biznesit: 70362915 Nr. Fiskal 600143614 në vazhdim “Furnizuesi”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet si më poshtë:

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE TE RENDIT TE IV-të

Nr. I prokurimit	633-18-3275-1-2-1/FA026
Nr. I brendshëm	633 / 018/ 020 / 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

1.2

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE TE RENDIT TE IV-të

~~Autoriteti Kontraktues bënë blejjet vetëm në emër të vetë Autoritetit~~

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative që Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me NËNSHKRIMIN E SAJË PERKATESISHT ME DATË 30.07.2018 DHE DO TE PERFUNDOJË ME SE LARTI DERI ME 30.07. 2019 PASI KONTRAKTORI TE DESHMOJE SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFISHMERI PREJ 13 MUAJVE, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TE KONTRATËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha FURNIZIMEVE do të jetë: **30.07.2019.**

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit dhe shërbimeve tjera do të jenë rrugët në FSHATRA TË TERITORIT TË KOMUNËS SË ISTOGUT – BAZUAR NE REKOMANDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi I dates: **02.07.2018**

Vlera totale indikative e kontratës është: **23.650,00 Euro.**

Dhe me shkronja: /Njëzetetremijëegjashtëpesedhjetëeuro /zerozero

4.2 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon +- 30% e vlerës së kontratës) po që se për këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues. Po që se urdherblerjet kalojnë sasinë totale të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%), pa marrë parasysh datën origjinale të nënshkrimit, e njëjta shkeputet automatikisht.

4.3 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike komizë.

4.4 ~~Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë komizë~~ 4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani për menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]2 in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktuesin:

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>"Shkëmbi" shpk</i>
Pozita:	<i>Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>Musa Metaj Menaxher</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>13. 08. 2018</i>	Data:	<i>13 - 08. 18</i>
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Fillimi i ekzekutimit të kontratës	2.3	Kontrata fillon të realizohet me nënshkrimin e saj me datë 13.08.2018 dhe do të përfundojë me datën 13.08.2019
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës në afat prej 13. Muajsh.
Sigurimi	10.1	Sikurse në KPK
Programi i ekzekutimit	11	<i>Furnizimi dhe ekzekutimi i furnizimeve do të kryhen bazuar në specifikimin teknik dhe planin dinamik, por jo më lart se 2. dy ditë nga kërkesa e bërë nga Njësit kërkuese, respektivisht Autoriteti kontraktues.</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>Do të vlejnë Ligjet e aplikuara për doganat, tatimet dhe taksat tjera të detyrueshme</i>
Patentat dhe licencat	13.1	Sikurse në KPP
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Furnizimet duhet të plotësojnë specifikat e detyrueshme të kërkuara në dosjen e tenderit, në të kundërtën, materiali që nuk i plotëson specifikat do të kthehet dhe nuk do të pranohet si i tillë.</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Organet Komunale të Istogut.</i>

Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e përgjithshme të kontratës, pas dorëzimit dhe pranimi të faturës dhe dokumentacionit përçjellës.
Dorëzimi	21.3	<i>Pranimi dhe dorëzimi i mallrave do të bëhet në rruget e specifikuar nga Drejtorati përkatës, në prani të zyrtarit për pranim dhe organeve tjera të Komunes së Istogut</i>
Obligimet e garancionit	24.1	
	24.5	<i>Materiali i porositur duhet të ketë garancion se paku një vit. Në të kundërt kontrata do të shkëputet..</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të sigurojë dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>Institucionet Komunale në Istog</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje Ekonomike Prishtinë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh

Autent.

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT: MIRËMBAJTJA E RRUGEVE LOKALE TE RENDIT - IV					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia e perafert	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
1	Furnizimi dhe Transporti i zhavorit	m ³	1000	3	3000
2	Furnizimi, Transporti dhe Shpërndarja e zhavorit me	m ³	5000	4	20000
4	Planifikimi dhe Gërmimi me Bulduzer	orë	60	5	300
7	Furnizimi me gypa betoni Ø 400	copë	50	1	50
8	Furnizimi me gypa betoni Ø 500	copë	50	1	50
9	Furnizimi me gypa betoni Ø 600	copë	30	1	30
10	Furnizimi me gypa betoni Ø 800	copë	20	1	20
11	Furnizimi me gypa betoni Ø 1000	copë	20	1	20
12	Furnizimi me kapak betoni për mbulimin e pusetave	copë	30	1	30
13	Hapja e kanaleve anësore	m'	1500	0,1	150
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					23,650,0 €

